

VENDIM
Nr. 642, datë 8.9.2016

PËR LEJIMIN E LËVIZJES JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 36 NEGATIVËVE PREJ XHAMI, PJESË E FONDIT TË MUZEUT KOMBËTAR TË FOTOGRAFISË “MARUBI”, SHKODËR, NË MUZEUN E FOTOGRAFISË SË AMSTERDAMIT - FOAM, HOLANDË, NË KUADËR TË ZHVILLIMIT TË EKSPOZITËS FOTOGRAFIKE “DINASTIA MARUBI -*MARUBI DYNASTY*” - 100 VITE TË STUDIOS FOTOGRAFIKE SHQIPTARE, NË AMSTERDAM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 36 negativëve prej xhami, pjesë e fondit të Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, Shkodër, në Muzeun e Fotografisë së Amsterdami - FOAM, Holandë, në kuadër të zhvillimit të ekspozitës fotografike “Dinastia Marubi-*Marubi DYNASTY*” - 100 vite të Studios Fotografike Shqiptare, në Amsterdam, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 13.9.2016 deri më 27.11.2016.

3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohen Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” të kryejë shoqërimin dhe kthimin e negativëve në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

5. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama